



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 00.5.2023

Nr:

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

**MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR
KRYETAR TË BASHKISË DHE PËR KËSHILLIN E BASHKISË, NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA
SHKODËR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 20.5.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Miratimi i tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, zona zgjedhore Bashkia Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, neni 123, neni 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Kjo zonë zgjedhore ka 4 (katër) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 2, ZAZ nr.3, ZAZ nr. 4, ZAZ nr. 5.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të zonave përkatëse për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, si dhe për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Bazuar në nenin 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor, është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të verifikojë dhe të nxjerrë rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore,

Data: . .2023 Nr: 00
Ora:



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin Bashkiak, në zonën zgjedhore Bashkia Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse

KZAZ nr. 2, KZAZ nr.3, KZAZ nr. 4, KZAZ nr. 5, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, tabelat përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi si për kryetarin dhe për këshillin, të ZAZ-ve të sipërcituara.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore si për Kryetarin dhe për Këshillin e Bashkisë Shkodër, u kontrolluan tabelat përmbledhëse të përkatësish ZAZ nr. 2, ZAZ nr.3, ZAZ nr. 4, ZAZ nr. 5, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve si për Kryetarin ashtu edhe për Këshillin, përfshijnë rezultatit e të gjitha tabelave të rezultateve çdo QV-je të zonës zgjedhore.

KQZ-ja do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Shkodër dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 123 dhe nenin 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpalljen fitues të z. Benet Beci si Kryetar i Bashkisë Shkodër, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: . .2023 Nr:
Ora:



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin Bashkiak, në zonën zgjedhore Bashkia Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KRYETARIN E BASHKISË

BASHKIA SHKODËR, QARKU SHKODËR

Lidhja 1



		ZAZ 2	ZAZ 3	ZAZ 4	ZAZ 5	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	73.740	32.959	31.621	31.219	169.539
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	24.393	13.081	11.046	10.226	58.746
3	Vota të pavlefshme	569	276	235	231	1.311
4	Vota të vlefshme	23.784	12.784	10.790	9.977	57.335
5	Fletë votimi të hedhura gabim	40	21	21	18	100
1	Benet Bahri Beci	15.189	7.340	6.098	5.904	34.531
2	Bardh Ali Spahia	8.595	5.444	4.692	4.073	22.804
	Totali i votave të vlefshme	23.784	12.784	10.790	9.977	57.335



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KËSHILLIN E BASHKISË

BASHKIA SHKODËR, QARKU SHKODËR



Lidhja 2

		ZAZ 2	ZAZ 3	ZAZ 4	ZAZ 5	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	73.740	32.959	31.621	31.219	169.539
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	24.379	13.078	11.048	10.230	58.735
3	Vota të pavlefshme	992	475	342	339	2.148
4	Vota të vlefshme	23.351	12.576	10.682	9.871	56.480
5	Fletë votimi të hedhura gabim	36	27	24	20	107
1	Bashkë Fitojmë	4781	3056	2891	2449	13177
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	6971	4170	3691	3131	17963
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	169	146	156	113	584
4	Partia Republikane Shqiptare	210	339	153	148	850
5	Partia Levizja e Legalitetit	146	431	296	178	1051
6	Partia Demokracia Sociale	138	70	76	92	376
7	Aleanca Liberale e Djathtë	709	395	239	300	1643
8	Partia Socialdemokrate	7451	1939	1561	1957	12908
9	Partia Demokratike	2271	1173	1081	1145	5670
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	50	87	78	44	259
11	Fryma e Re Demokratike	369	643	337	257	1606
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	86	127	123	57	393
	Totali i votave të vlefshme	23.351	12.576	10.682	9.871	56.480